


REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGENCJA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

| | | |
|---------------|-----------|------------|
| Dep. | 2-D /DPK | Nr. Prot. |
| Dep. | | Br. Prot. |
| Dep. | | Prot No. |
| Nr. I faq. | 01-844/15 | |
| Broj stranica | | Date |
| Nr. pages | 04 | Datum |
| | | 23.03.2015 |
| PRISHTINË | | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

| | |
|-------------------------------|---|
| DATË/A: | 20.03.2014 |
| REFERENC-Ë: | AKK-DPK-DPKI-03-02-347/14 |
| PËR/ZA/TO: | Znj. Hikmete Bajrami, Ministre në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) |
| CC: | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | |
| NGA/OD/FROM: | Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | OPINION lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit |

E nderauara znj. Bajrami,

Në bazë të shkresën tuaj të datës 06.02.2015, ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korruptionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I.), Agjencia; "bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave", (Neni 19, pika 1.5, e Ligjit Nr.04/L-051).

OPINION

- I. Në bazë të informacioneve zyrtare nga Agjencioni për regjistrimin e bizneseve në Kosovë, pastaj në bazë të kritereve për Autorizim të operatorëve për “Trup për Vlerësimin e Konformitetit” si dhe duke u bazuar në legjislacionin përkatës, në lidhje me bizneset “Ex Fis” dhe Ex-Fis Labs” konstatojmë se; nuk ka konflikti interes i faktik mes këtyre dy bizneseve të dyshuara.
- II. Për të evituar “konfliktin rast për rast” dhe për të rregulluar më mirë situatat e mundshme me konflikt interes, Agjencia kundër Korruspcionit jep rekomandimet e veta.

ARSYETIM

I. Pyetja e juaj konkrete ka të bëjë me një situatë në të cilën keni hedhë dyshimin për konflikt interes, sepse personat kompetent nga MTI, kanë lëshuar autorizim (Nr.12/2014) për një kompani private (“Ex Fis Labs” sh.p.k.) për të bërë analizat e cilësisë së naftës (Trupa për vlerësimin e konfirmitetit), por e cila në të njejten kohë edhe vet është importuese e naftës ?

Në bazë të analizimit të informacioneve të marrura në Agjencionin e Regjistimeve të biznesit (ARBK), pastaj porcesit të dhënjes së autorizimeve, analizës së bazës ligjore në lidhje me këtë çështje dhe konsultimeve me zyren ligjore të MTI-së dhe në bazë të gjendjes reale të vërtetuar me informatat mbi këto biznese; konstatojmë se nuk ka konflikti interes i faktik në mes të dy bizneseve të dyshuara.

Në fakt, është vërtetuar se biznesi “Ex Fis Labs” Sh.p.k. është themeluar nga “Ex-Fis” Sh.p.k (DPK/DPKI-03-02-347/15).

Në kohën kur këto biznese kryenin shërbime si të ndara, “Ex-Fis” importues, ndërsa “Ex Fis Labs” që kishte aplikuar në MTI për autorizim si “Trup për vlerësimin e konformitetit”, vet MTI

e ka refuzuar për shkak se kjo ka qenë e ndaluar me ligjin; “Për kërkeshat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit” (Nr.04/L-039), konkretisht me Nein 16 paragrafi 2 i cili shprehimisht thotë:

“Trupi për vlerësim të konformitetit nuk mund të jetë subjekt ekonomik për ato produkte të cilat janë objekt i vlerësimit të tij, si dhe nuk mund të jetë i përfshirë direkt në projektimin, prodhimin, perpunimin, tregtimin, instalimin, përdorimin dhe mirëmbajtje të atye produkteve”.

Pikërisht duke u bazuar në këtë pike, Zyra ligjore në MTI kishte sqaruar se kërkesa e “Ex-Fis Labs” duhet refuzuar për shkak se “Ex-Fis” është themeluese e asaj firme dhe njëkohësisht importues.

Ndërkohë në Agjencionin për regjistrimin e bizneseve (ARBK), “Ex-Fis Labs” sh.p.k., duke u bazuar në nenin 33 të Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare, nr.02/L-123, ka paraqitur një Aneks Statut në bazë të cilit pronari “Ex-Fis” me vtdëshirë është larguar nga pronësia mbi “Ex Fis Labs”.

Pronar i ri i biznesit “Ex Fis Labs” sh.p.k. bëhet Muhamet Uka, ndërsa transaksioni i aksioneve bëhet me falje. Ky aneks ka hy në fuqi me 31.07.2014.

Me pastaj, në ftesën publike të MTI-së 01-10 nëntor 2014 për shprehje të interesit për autorizim si Trup të vlerësimit të konformitetit (TVK) ka aplikuar edhe “Ex Fis Labs” sh.p.k., tanë me pronar Muhamet Uka, dhe me person të autorizuar Valdet Teneqja.

Komisioni prej pesë anëtareve në kuadër të MTI-së i formuar për vlerësimin e kushteve për dhënien e propozimit për autorizim të Trupave për Vlerësimin e Konformitetit për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe kushteve tjera të kërkuar, në fund të raportit të vet ka dhënë rekomandimin që Operatori Ekonomik “Ex Fis Labs” te Autorizohet si Trup për vlerësimin e konformitetit (MTI-KOM-Nr.prot.9315, dt.04.12.2014).

Në shqyrtim të situatës së dyshuar për konflikt interesit, mes biznesit importuese të naftës “Ex Fis” dhe biznesit “Ex-Fis Labs” sh.p.k. që është i autorizuar si “Trup për vlerësimin e



konformitetit”, tani informatat mbi bizneset (DPK-DPKI-03-02-689/15) na thonë se këto dy biznese nuk kanë asgjë të përbashkët me çka mund ta cilësonim si konflikt interesit.

Ndërsa dyshimi që vjen nga personat kompetent nga MTI, e që bazohet në ate se dikur “Ex Fis” ka qenë themelues i “Ex Fis Labs” do të duhej të ishte i rregulluar me kritere për dhënjen e autorizimeve.

Zatën, tani ky do të jetë edhe një nga rekomandimet që u jep Agjencia kundër Korrupsion në lidhje me raste të kësaj natyre.

II. Rekomandimet që dalin nga Agjencia kundër Korrupsion (AKK) për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) nga krejt kjo problematikë janë këto:

- Të parashihen kufizime ose ndalesa për situata të konfliktit të interesit në kuadër të caktimit të kritereve për Autorizim.
- Të krijohet një sistem rregullash për Trupat e vlerësimit të konformitetit (TVK) të cilat po ashtu duhet të shmangun çdo situatë të konflikti të interesit.
- Të krijohen dokumente të brendshme (Kode të etikës, apo të ngjishme) në të cilat pjesë të rëndësishme do të zinte edhe rregullimi i situatave të konflikti të interesit.

P
*
OSOVO

Agjencia kundër Korrupsion (AKK) shprehë gatishmërinë që, në pajtim me ligjin për Parandalimin e konflikti të interesit, në cilësinë e autoritetit qendror për mbikqyrjen e zbatimit të Ligjit për Parandalimin e konflikti të interesit të ofroj ndihmë profesionale dhe teknike për këshillimin dhe mbështetjen e nismave ligjore dhe nënligjore të ndërrmarra nga institucionet publike, për parandalimin e konfliktit të interesave.